



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



**RREGULLORE Nr. 17/ 2026
PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET
E UJIT NË KOSOVË**

Qershor 2026

PËRMBAJTJA

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	4
Neni 1 Qëllimi	4
Neni 2 Fushëveprimi	4
Neni 3 Përkufizimet	4
KREU II POLITIKAT, KOMPETENCAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE	8
Neni 4 Parimet që zbatohen gjatë përcaktimit të tarifave të shërbimeve të ujit	8
Neni 5 Kompetencat për përcaktimin e tarifave	9
Neni 6 Politikat e përgjithshme tarifore	9
Neni 7 Parimet e politikave tarifore për shërbimet e ujit	10
Neni 8 Politikat tarifore për shërbimet e ujit me shumicë	11
KREU III METODOLOGJIA TARIFORE	12
Neni 9 Komponentët e kërkesës për të hyra	12
Neni 10 Metodatat e llogaritjes së tarifave	13
Neni 11 Struktura e tarifave	14
Neni 12 Tarifa e mbingarkesës	15
KREU IV PROCEDURA E APLIKIMIT DHE SHQYRTIMIT TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT	15
Neni 13 Aplikacioni për tarifatat e shërbimit	15
Neni 14 Shqyrtimi i aplikacionit	16
KREU V KONSULTIMET PUBLIKE	17
Neni 15 Vendimi për mbajtjen e konsultimeve me publikun dhe palët e interesit	17
Neni 16 Organizimi i konsultimeve me publikun dhe palët e interesit	17
Neni 17 Prezantimi i tarifave të procesit tarifor	17
Neni 18 Njoftimi për konsultime me publikun dhe palët e interesit	18
Neni 19 Procedurat e mbajtjes së konsultimeve me publikun dhe palët e interesit	18
Neni 20 Rregullat e mbajtjes së konsultimeve me publikun dhe palët e interesit	18
Neni 21 Transkriptimet	19
Neni 22 Dokumentacioni	19
Neni 23 Raportimi	19
KREU VI PROCEDURAT E MIRATIMIT DHE RISHIKIMIT TË TARIFËS	19
Neni 24 Miratimi i tarifave të shërbimit	19
Neni 25 Rishikimi i jashtëzakonshëm i tarifave gjatë periudhës tarifore	20
Neni 26 Procedurat e miratimit për rishikim të jashtëzakonshëm të tarifave të shërbimit	20
KREU VII PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT	21
Neni 27 Publikimi i tarifave të shërbimit	21
KREU VIII FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM PËR QËLLIME TREGTARE DHE ANKESAT	21
Neni 28 Furnizimi me ujë të pijshëm për qëllime tregtare	21
Neni 29 Ankesat	22
KREU IX DISPOZITAT KALIMTARE	22

Neni 30 Aplikimi i ndërsbvencionimit	22
Neni 31 Aplikimi i tarifës së mbingarkesës.....	22
KREU X DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE	23
Neni 32 Gjuha zyrtare	23
Neni 33 Shfuqizimi	23
Neni 34 Hyrja në fuqi	23
SHTOJCAT	24

Në mbështetje të nenit 4, nën paragrafi 3.6, nenit 19, paragrafi 3 dhe nenit 47, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit nxjerr:

RREGULLORE NR. 17/2026 PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJIT NË KOSOVË

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të krijojë rregulla dhe procedura sipas të cilave shqyrtohen, përcaktohen, dhe zbatohen tarifat për shërbimet e furnizimit me ujë, grumbullimi, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura, si dhe furnizimi me ujë të trajtuar dhe të pa trajtuar me shumicë.
2. Kjo Rregullore gjithashtu i përcakton politikat, parimet, procedurat dhe afatet kohore për zbatimin e proceseve të rregullta dhe të jashtëzakonshme tarifore.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme për Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit, të gjithë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit, si dhe për të gjitha palët e përfshira në ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve të ujit.

Neni 3 Përkufizimet

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore do kenë kuptimet si në vijim:
 - 1.1. **Autoriteti** - Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) si autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesit të shërbimeve në Kosovë;
 - 1.2. **Aplikacioni për tarifat e shërbimit** – është dokumenti i dorëzuar Autoritetit nga ofruesit e shërbimeve, në formatin e përcaktuar nga Autoriteti;
 - 1.3. **Asetet infrastrukturore** – janë asetet kryesisht nëntokësore, të cilat nëse mirëmbahen siç duhet, ofrojnë shërbim të qëndrueshëm për një kohë të pacaktuar;

- 1.4. **Asetet jo infrastrukturore** – janë asetet kryesisht sipërfaqësore, përfshirë impiantet e trajtimit të ujit dhe ujërave të ndotura, stacionet e pompimit, laboratorët, depot dhe punëtoritë;
- 1.5. **Baza rregullatore e aseteve (BRRA)** – është vlera e aseteve të njohura për qëllime tarifore, e përcaktuar sipas Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator;
- 1.6. **Efluentët e tregtisë** – janë ujërat e ndotura të konsumatorëve tregtarë ose industrialë, cilësia e të cilave dallon ndjeshëm nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura;
- 1.7. **Formula Mogden** – është formula për përcaktimin e tarifave për ujërat e ndotura industriale, bazuar në cilësinë e shkarkimit;
- 1.8. **Granti** – është mjet financiar i dhënë nga një institucion publik, organizatë ndërkombëtare, donator apo subjekt tjetër juridik, për financimin e një qëllimi të caktuar, pa obligim kthimi;
- 1.9. **Humbjet e dukshme (aparente)** – janë humbjet e ujit që rezultojnë nga keqleximi i ujëmatësve, pajisjet e vjetërsuara ose të pakalibruara dhe konsumatorët e paregjistruar;
- 1.10. **Humbjet reale (teknike)** – janë humbjet e ujit si pasojë e rrjedhjeve fizike në rrjet, për shkak të vjetërsisë, cilësisë së dobët të gypave ose presionit të paekuilibruar;
- 1.11. **Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK)** – është indeksi për matjen e inflacionit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- 1.12. **Kategoria e konsumatorëve** - kategoria e konsumatorëve të definuar si në vijim:
 - 1.12.1. **Konsumator shtëpiak** –konsumatori i klasifikuar nga ofruesi i shërbimeve si person i cili shfrytëzon shërbimet në banesën e tij apo saj për nevoja të amvisërisë;
 - 1.12.2. **Konsumator komercial/industrial** - personi, subjekti ligjor ose organizata afariste e klasifikuar nga ofruesi i shërbimeve si konsumator i cili shfrytëzon shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
 - 1.12.3. **Konsumator institucional**- subjekti ligjor i klasifikuar nga ofruesi i shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare Nr. 02/L-123;
- 1.13. **Kërkesa për të hyra** - është shuma e mjeteve financiare të nevojshme për mbulimin e kostove të ofrimit të shërbimeve, përfshirë kthimin e arsyeshëm në kapital;

- 1.14. **Kompensimi** – është procesi i rregullimit të të hyrave për të kompensuar konsumatorët për investime të miratuara, por të porealizuara në periudhat e mëparshme tarifore;
- 1.15. **Kontabiliteti i kostos aktuale** – është metodë kontabiliteti që paraqet asetet sipas kostos së tyre aktuale ose të zëvendësimit;
- 1.16. **Shpenzimet operative** – janë shpenzimet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e shërbimeve të ujit;
- 1.17. **Kthimi në kapital** – është kthimi i bazuar dhe i arsyeshëm në vlerën e investimeve të bëra nga ofruesi i shërbimeve dhe/ose pronari/ët e tij;
- 1.18. **Lista e tarifave të shërbimit** – janë të gjitha tarifat e shërbimeve të miratuara nga Autoriteti për ofruesit e shërbimeve;
- 1.19. **Mbulimi i kostos** – është koncepti ku tarifat e shërbimeve të ujit mbulojnë kostot operative, investimet, si dhe kthimin e arsyeshëm në kapital.
- 1.20. **Mirëmbajtja kapitale** – janë aktivitetet e planifikuara dhe të pa planifikuara për zëvendësimin dhe riparimin e aseteve për ruajtjen e nivelit bazë të shërbimit;
- 1.21. **Modeli i çmimit të aseteve kapitale** – është mjet ekonomik për përcaktimin e kthimit në kapital, bazuar në rrezikun e sektorit të shërbimeve të ujit;
- 1.22. **Ndër-subvencionimi** – është përdorimi i të ardhurave nga një kategori konsumatorësh për mbulimin e shpenzimeve të kategorive tjera.
- 1.23. **Niveli ekonomik i rrjedhjeve (humbjeve)** – është niveli i rrjedhjeve (humbjeve) të ujit ku investimet e reduktimit të mëtejshëm tejkalojnë përfitimet ekonomike.
- 1.24. **Ofrues i shërbimeve** - është çdo ofrues i shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit me shumicë;
- 1.25. **Politika tarifore** – janë parimet rregullatore mbi të cilat përcaktohen tarifat e shërbimit.
- 1.26. **Investimet në rritje/zgjerim** – është rritja ose zgjerimi i bazës së aseteve dhe/ose nivelit të shërbimit.
- 1.27. **Struktura e Tarifave** – janë elementet përbërëse të tarifave që përfshijnë tarifat fikse dhe volumetrike.
- 1.28. **Investimet kapitale** – janë investimet e ofruesit të shërbimeve të ujit për blerjen, ndërtimin, zgjerimin, përmirësimin e aseteve fikse afatgjata, që krijojnë ose rrisin vlerën e aseteve dhe kanë jetëgjatësi më shumë se një vit;
- 1.29. **Tarifa me rritje drastike (“Shock tariffs”)** – është rritje e lartë, e papritur dhe e menjëhershme e tarifave, që mund të krijojë ndikim të rëndë financiar për

konsumatorët.

- 1.30. **Tarifa fikse** – nënkupton tarifë mujore të përcaktuar sipas madhësisë (diametrit) të gypit të kyçjes, e detyrueshme për çdo konsumator të lidhur në rrjetin e ofruesit të shërbimeve, e cila paguhet pavarësisht nga konsumi i ujit dhe mbulon kostot administrative, përfshirë edhe zëvendësimin periodik të ujëmatësve.
- 1.31. **Tarifa volumetrike** – është komponenti i strukturës tarifore që aplikohet mbi bazën e volumit të ujit të konsumuar dhe/ose volumit të ujërave të ndotura të shkarkuara.
- 1.32. **Tarifa për realizimin fizik të lidhjes së re** – është tarifë që aplikohet nga ofruesi i shërbimeve për realizimin fizik të lidhjeve të reja në shërbimet e ujit, që përpos gypave dhe pjesëve fazonike, përfshinë pajisjet matëse të rrjedhjes, punët e dheut, betonit, asfaltimit dhe punën e ekipeve të ofruesit të shërbimeve, sipas listës së miratuar nga Autoriteti;
- 1.33. **Tarifa për inspektimin e lokacionit për lidhje të re dhe pranimit teknik i lidhjes** – është tarifë që aplikohet nga ofruesi i shërbimeve për inspektimin, definimin e lokacionit të lidhjes së re dhe për pranimit teknik të lidhjes;
- 1.34. **Tarifa për ndërprerjen e përkohshme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit** – është tarifë që aplikohet nga ofruesi i shërbimeve për ndërprerje të përkohshme të lidhjes, e që nënkupton ndërprerjen e rrjedhjes së ujit në gypin furnizues të konsumatorit përmes valvulës apo pajisjeve tjera të përshtatshme dhe plumbimit të këtyre pajisjeve që dëshmon se rrjedhja është ndërprerë përkohësisht;
- 1.35. **Tarifa për ri-lidhje në rrjetin e ujësjellësit** – është tarifë që aplikohet nga ofruesi i shërbimeve për largimin e plumbës dhe pajisjeve tjera që janë instaluar për ndërprerje të përkohshme të lidhjes;
- 1.36. **Tarifa për ndërprerjen e përhershme të lidhjes** – është tarifë që aplikohet nga ofruesi i shërbimeve me qëllim të shkëputjes fizike të gypit të lidhjes së konsumatorit nga gypat kryesor të rrjetit të ujësjellësit apo kanalizimit
- 1.37. **Tarifa për testim, riparim dhe kalibrim të ujëmatësit** – është tarifë që aplikohet nga ofruesi i shërbimeve me qëllim të testimit të saktësisë së regjistrimit të ujëmatësve, riparimit të ujëmatësit dhe kalibrimit të tij
- 1.38. **Tarifa e mbingarkesës** – është tarifë për përforcim të infrastrukturës si pasojë e efekteve kumulative të ndërtimeve të shumta në rrjetin shpërndarës të ujit ose kanalizimit, që zbatohet për çdo konsumator të ri që lidhet në rrjet.
- 1.39. **Urdhëresa tarifore e shërbimit** – është dokument i lëshuar nga Autoriteti ku janë të përfshira të gjitha tarifat e miratuara të shërbimit sipas kategorisë së konsumatorëve;
- 1.40. **Vlerësim i përshpejtuar i planeve të biznesit** – Vlerësim për plane të cilësisë së lartë, të mbështetura në prova dhe parashikime realiste;

- 1.41. **Vlerësim i ngadaltë i planeve të biznesit** – Vlerësim për plane që nuk përmbushin kriteret e vlerësimit të përshpejtuar;
 - 1.42. **Zhvlerësimi i asetëve** - shpërndarja e vlerës së një asemi gjatë jetës së tij të dobishme për të reflektuar konsumimin dhe vjetërsimin e tij në kostot e shërbimeve të ujit.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin përkatës për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

KREU II

POLITIKAT, KOMPETENCAT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

Neni 4

Parimet që zbatohen gjatë përcaktimit të tarifave të shërbimeve të ujit

Gjatë procesit të përcaktimit të tarifave të shërbimeve të ujit zbatohen këto parime:

1. Ligjshmëria – Përcaktimi i tarifave bëhet në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.
2. Transparenca – Procesi i vendimmarrjes lidhur me tarifën duhet të jetë i hapur, i arsyetuar dhe i dokumentuar, duke mundësuar informimin e plotë të palëve të interesuara.
3. Reflektueshmëri kostosh - Tarifën e shërbimeve të ujit duhet të synojnë reflektimin sa më të plotë dhe të drejtë të kostove të arsyeshme të ofrimit të shërbimit,
4. Mosdiskriminimi – Tarifën aplikohen në mënyrë të barabartë për konsumatorët që gjenden në kushte të njëjta, pa dallime të pajustificuara ndërmjet kategorive.
5. Mbulimi i kostos dhe qëndrueshmëria financiare – Tarifën duhet të sigurojnë mbulimin e kostove të arsyeshme operative, mirëmbajtjes, investimeve dhe kthimin e arsyeshëm në kapital, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm të shërbimit.
6. Proporcionaliteti – Niveli i tarifës duhet të jetë në përpjesëtim me nivelin e shërbimit të ofruar dhe kostot përkatëse.
7. Efikasiteti dhe përdorimi racional i ujit – Struktura tarifore duhet të nxisë përdorimin racional të burimeve ujore dhe përmirësimin e performancës së ofruesit të shërbimeve.
8. Përbalueshmëria – Gjatë përcaktimit të tarifave merret në konsideratë ndikimi social dhe ekonomik te konsumatorët.

Neni 5

Kompetencat për përcaktimin e tarifave

1. Organi i vetëm kompetent për caktimin dhe miratimin e tarifave të shërbimeve të ujit në Kosovë është Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit.
2. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit do të bëhet sipas ligjeve në fuqi dhe metodologjisë tarifore, që hartohen dhe miratohen nga Autoriteti.
3. Për mos përmbushje të standardeve të cilësisë së ujit do të aplikohen rregullime proporcionale të tarifave ose mekanizma kompensues, si në vijim:
 - 3.1 Nëse mos përmbushja e standardeve të cilësisë së ujit zgjat për një periudhë prej një (1) muaji ose më tepër, konsiderohet se plotësohen kushtet për kompensim të konsumatorëve të prekur;
 - 3.2 Në rastet e përcaktuara në pikën 3.1 të këtij neni, tarifa e aplikueshme për shërbimin e furnizimit me ujë do të jetë në nivelin prej 60% (gjashtëdhjetë për qind) të tarifës bazë në fuqi, për periudhën gjatë së cilës është konstatuar mos-përmbushja nga autoriteti kompetent.
 - 3.3 Autoriteti, para nxjerrjes së vendimit për zbatimin e masave të përcaktuara në nënparagrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni, do të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës të kushteve dhe faktorëve që kanë ndikuar në mos përmbushjen e standardeve të cilësisë së ujit.
4. Çdo konsumator që furnizohet me ujë nga Ofruesi i Shërbimeve për qëllime tregtare do t'i nënshtrohet, përveç tarifave të miratuara sipas kësaj Rregulloreje, edhe pagesës së tarifave për leje ujore të aplikueshme nga ministria përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Politikat e përgjithshme tarifore

1. Politikat tarifore kanë për qëllim sigurimin e një ekuilibri të qëndrueshëm dhe të drejtë mes palëve të ndryshme të interesit, duke garantuar ofrimin e shërbimeve të ujit me nivel të pranueshëm të shërbimit dhe çmime të arsyeshme, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe parimet e rregullimit të sektorit.
2. Tarifat e shërbimeve të ujit përcaktohen në mënyrë të drejtë, objektive dhe jodiskriminuese, duke siguruar që konsumatorët e së njëjtës kategori në kushte të njëjta ose të krahasueshme të trajtohen në mënyrë të barabartë,
3. Tarifat duhet të përcaktohen në bazë të kërkesës për të hyra, të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e ofruesit të shërbimeve, në përputhje me legjislacionin aktual dhe kontabilitetin rregullator.
4. Tarifat e shërbimeve të ujit duhet të jenë të tilla që nxisin rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e performancës së shërbimeve të ujit, duke krijuar nxitje për përdorimin racional të burimeve, kontrollin e kostove dhe rritjen e cilësisë, vazhdimësisë dhe besueshmërisë së shërbimit.

5. Tarifat e shërbimeve të ujit përshtaten me ndryshimet e nivelit të inflacionit, me qëllim ruajtjen e vlerës reale të të ardhurave dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimeve, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga Autoriteti.
6. Rikuperimi i kostos së investimeve kapitale. Investimet kapitale në përtëritjen e infrastrukturës, përfshihen në tarifa në të njëjtën mënyrë si shpenzimet operative. Për asetet joinfrastrukturore, zbatohet zhvlerësimi sipas kostos aktuale. Zhvlerësimi, kur aplikohet, duhet të zbatohet vetëm për ato asete që janë financuar nga vetë ofruesit e shërbimeve, përkatësisht, zhvlerësimi nuk aplikohet për asetet e financuara nga grantet.
7. Politikat tarifore do të miratohen pas procesit të konsultimit me palët e interesit, do të publikohen për qasje publike dhe do të rishikohen periodikisht nga Autoriteti, nëse vlerësohet se politikat ekzistuese tarifore nuk përmbushin objektivat e përcaktuara rregullatore.

Neni 7

Parimet e politikave tarifore për shërbimet e ujit

1. Përveç nëse ndryshe vendoset nga Autoriteti, ofruesit e shërbimeve duhet të përdorin tarifën e njëjta në zonat e tyre të shërbimit.
2. Autoriteti mund të përcaktojë tarifa zonale nëse e konsideron të arsyeshme, për raste specifike, me një vendim brenda rajonit të caktuar të shërbimit, pa i ndikuar tarifën ekzistuese të pjesës tjetër të rajonit përkatës.
3. Tarifat për shërbimet e ujësjellësit dhe për shërbimet e ujërave të ndotura rregullohen si shërbime të ndara tarifore dhe nuk lejohet ndër-subvencionimi ndërmjet këtyre dy shërbimeve.
4. Tarifat do të përfshijnë një mekanizëm rregullues për të marrë parasysh çdo ndryshim ndërmjet investimeve të miratuara dhe atyre të realizuara, i cili do të bartet dhe reflektohet në procesin pasues tarifor.
5. Ofruesit të shërbimeve u lejohet një kthim i arsyeshëm në kapital nga BARRA. Vlera fillestare e BARRA rregullohet në çdo periudhë rishikimi për të përfshirë të gjitha investimet e mëvonshme minus zhvlerësimin, kur është e aplikueshme, dhe përshtatur me inflacion në vlera të kostos aktuale të kontabilitetit.
6. Autoriteti do të përcaktojë një kthim të përshtatshëm në kapital, nga BARRA të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë të dhënat nga mjedise ekonomike të ngjashme në Evropë. Kthimi në kapital do të merr parasysh madhësinë relative të ofruesve të shërbimeve dhe do të aplikohet një bonus për ofruesit e vegjël të shërbimeve, kur është e përshtatshme.
7. Ndërsubvencionimi i tarifave për shërbimet e ujërave të ndotura ndërmjet kategorisë së konsumatorëve shtëpiak dhe joshtëpiak do të mbetet në fuqi si masë e përkohshme rregullatore deri në zbatimin e formulës Mogden për përcaktimin e tarifave të ujërave të ndotura.

8. Ofruesi i shërbimeve të ujit nuk ka obligim ligjor për subvencionimin apo kompensimin e faturave të konsumatorëve me të ardhura të ulëta. Çdo masë mbështetëse për këta konsumatorë sigurohet nga institucionet kompetente qeveritare, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
9. Tarifat e shërbimeve do të përcaktohen në mënyrë që të sigurojnë reflektim sa më të plotë dhe të drejtë të kostove reale të ofrimit të shërbimit, për aq sa është praktikisht e arsyeshme.
10. Tarifat për furnizim me ujë dhe të shërbimeve të ujërave të ndotura, do të bazohen në një pritshmëri për reduktimin e humbjeve të dukshme/aparente, që do të sjellë tarifa më të ulëta. Humbjet reale të ujit matën në nivel ekonomik të rrjedhjeve dhe, në rast se vlerësohet se ofruesi i shërbimeve nuk ka arritur të reduktojë këto humbje, kostot që tejkalojnë nivelin ekonomik të rrjedhjeve nuk do të njihen për qëllime tarifore dhe do të përjashtohen nga baza e kostos për përcaktimin e tarifave në periudhën pasuese tarifore.
11. Për konsumatorët josthtëpiak, në rastet kur cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara ndryshon ndjeshëm nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura në sistem, tarifat do të përcaktohen duke u bazuar në cilësinë e efluentit të shkarkuar, kur kjo është e aplikueshme dhe e matshme.
12. Konsumatorët që përdorin vetëm sistemin e ujërave të ndotura, do të jenë subjekt i një tarife fikse, për të mbuluar kostot e faturimit dhe administrimit.
13. Në rastet kur vëllimi i ujërave të ndotura të shkarkuara nga konsumatori ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga vëllimi i ujit të furnizuar nga Ofruesi i Shërbimeve, për qëllime të faturimit të shërbimeve të ujërave të ndotura do të kërkohet instalimi i një matësi, e në mungesë të një matësi, vëllimi i ujërave të ndotura do të përcaktohet përmes vlerësimit teknik.

Neni 8

Politikat tarifore për shërbimet e ujit me shumicë

1. Tarifat për shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë, duhet të përcaktohen në bazë të kostove aktuale të furnizimit tek secili ofrues i shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.
2. Tarifat duhet të përcaktohen për të reflektuar kostot e vërteta të furnizimit dhe nuk duhet të lejohen për çfarëdo efekti të ndër subvencionimit. Tarifat nuk duhet të aplikohen në mënyrë uniforme për të gjithë ofruesit e shërbimeve, por duhet marrë parasysh kushtet, kostot dhe karakteristikat specifike të secilit ofrues të shërbimeve.
3. Furnizuesi i ujit me shumicë duhet të shpërndajë qartë dhe në mënyrë transparente shpenzimet dhe investimet që dedikohen për dërgimin e ujit me shumicë.
4. Në rastet kur rritet vëllimi i ujit të dërguar tek ofruesi i shërbimit (pika të reja të furnizimit) gjatë kalkulimit të tarifës duhet të reflektohet edhe sasia shtesë e ujit të shitur, e cila ndikon edhe në pikat tjera të furnizimit të ujit me shumicë.
5. Mbulimi i kostos përkufizohet si rrjedhja e të hyrave që është e mjaftueshme për të

financuar aktivitetet e furnizuesit të ujit me shumicë si dhe për kthim të arsyeshëm të kapitalit i cili investohet, kur është e aplikueshme.

6. Tarifat mund të përcaktohen mbi bazën vjetore të tyre. Politikat tarifore mund të përpilohen me një grup të kompletuar të rregullave që mundësojnë periudhat më të gjata në mes të proceseve tarifore.

KREU III METODOLOGJIA TARIFORE

Neni 9 Komponentët e kërkesës për të hyra

1. Kërkesa për të hyra përbëhet nga shuma vjetore e të ardhurave të nevojshme për financimin e aktiviteteve të ofruesit të shërbimit, përfshirë:
 - 1.1 shpenzimet operative;
 - 1.2 shpenzimet për mirëmbajtjen kapitale, e përbërë nga:
 - 1.1.1 Përtëritjet infrastrukturore (financimi i domosdoshëm për të ruajtur shërbyeshmërinë e aseteve infrastrukturore nëntokësore), dhe
 - 1.1.2 Zhvlerësimi sipas kostos aktuale për asetet joinfrastrukturore (kryesisht ato mbi tokësore).
 - 1.3 kthimi i lejuar mbi Bazën Rregullatore të Aseteve (BRRA);
 - 1.4 shpenzime të tjera të lejuara sipas rregullimit.
2. Shpenzimet operative dhe kapitale pranohen vetëm nëse janë efikase, të nevojshme dhe të mbështetura me prova.
3. Grantet dhe kontributet kapitale zbriten nga kërkesa për të hyra në përputhje me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator.
4. Të ardhurat nga tarifat e lidhjes, rilidhjes dhe kontribute të tjera jovolumore zbriten nga kërkesa neto për të hyra.
5. Shpenzimet operative dhe investuese të parashikuara do të regjistrohen si të tilla sipas njërës prej dy kategorive kryesore të shërbimeve të:
 - 5.1 Furnizimit me ujë.
 - 5.2 Shërbimeve të ujërave të ndotura.
6. Shpenzimet për shërbimet e furnizimit me ujë ndahen në:
 - 6.1. Shpenzimet direkte përfshijnë
 - 6.1.1. Burimet dhe trajtimi i ujit
 - 6.1.2. Shpërndarjen e ujit

- 6.2. Shpenzimet indirekte që përfshijnë:
 - 6.2.1. Aktivitetet e centralizuara të biznesit (shërbimet për konsumatorët, shpenzimet e përgjithshme etj.)
7. Shpenzimet për shërbimet e ujërave të ndotura ndahen në:
 - 7.1. Shpenzime direkte të përbëra nga:
 - 7.1.1. Mbledhja e ujërave të ndotura
 - 7.1.2. Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura
 - 7.1.3. Trajtimi dhe përpunimi i llumit
 - 7.2. Shpenzimet indirekte që përfshijnë:
 - 7.2.1. Aktivitetet e centralizuara të biznesit (shërbimet për konsumatorët, shpenzimet e përgjithshme etj.)
8. Investimet Kapitale, kategorizimi i aseteve
 - 8.1. Asetet infrastrukturore janë asete me jetëgjatësi të papërcaktuar, të cilat, me mirëmbajtje adekuate dhe zëvendësim periodik të komponentëve kryesorë, sigurojnë ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve për konsumatorët. Këto asete nuk i nënshtrohen zhvlerësimit. Mirëmbajtja kapitale e tyre reflektohet përmes investimeve në përtëritjen e infrastrukturës, e cila përfshihet në kërkesën për të ardhura. Investimet për përmirësimin, zgjerimin ose rritjen e nivelit të shërbimit të rrjetit shtohen në Bazën Rregullatore të Aseteve (BARRA), në përputhje me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator.
 - 8.2. Asetet jo infrastrukturore janë asete me jetëgjatësi të përcaktueshme, të cilat pritet të zëvendësohen ose të nxirren nga përdorimi në fund të jetës së tyre të dobishme. Këto asete i nënshtrohen zhvlerësimit mbi bazën e kostos aktuale gjatë periudhës së tyre të pritshme të përdorimit.
9. Investimet për rritjen dhe zgjerimin e aseteve infrastrukturore shtohen në BARRA dhe vlera e saj e shtuar ruhet përjetësisht. BARRA që përbëhet nga BARRA fillestare, plus çdo përmirësim (pa zbritur zhvlerësimin), i nënshtrohet indeksimit me inflacion në secilën periudhë të rishikimit të tarifave. BARRA e indeksuar me inflacion i nënshtrohet një norme kthimi, e cila bartet në kërkesën për të ardhura
10. Plani i investimeve kapitale të ofruesit të shërbimeve duhet të jenë në harmoni me ‘Planin e Biznesit’, ‘Planin Afatgjatë të Investimeve’, dhe ‘Planin e Menaxhimit të Aseteve’(PMA).
11. Autoriteti ka të drejtën të caktojë ofruesit të shërbimeve minimumin dhe maksimumin e investimeve gjatë përcaktimit të tarifave, duke pasur për bazë ruajtjen e nivelit të shërbimit, qëndrueshmërinë financiare si dhe përbalueshmërinë tarifore.

Neni 10

Metodat e llogaritjes së tarifave

1. Tarifat e ujit në Kosovë bëhen sipas metodologjisë “Price Cap”, e cila përcakton kufirin maksimal të lejuar të tarifave për një periudhë të caktuar rregullatore, duke marrë parasysh

inflacionin dhe objektivat e efikasitetit, me qëllim kontrollimin e ndikimit të çmimeve, mbrojtjen e konsumatorëve dhe nxitjen e përmirësimit të performancës së ofruesve të shërbimeve.

2. Tarifa përcaktohet nga kërkesa për të ardhura, që i plotëson kushtet e specifikuar nën pikën 1 të këtij neni, pjesëtuar me vëllimin e ujit të shitur.
3. Tarifat e ujit llogariten mbi bazën e vëllimit të shitjeve të ujit të faturuar, ndërsa tarifat e ujërave të ndotura llogariten me vëllimin e shitjeve të ujërave të ndotura për ata konsumatorë që kanë qenë të kyçur në sistemin e ujërave të ndotura për atë vit.
4. Shitjet e vlerësuara me qëllim të caktimit të tarifave për ujërat e ndotura, do të përcaktohen, për ata konsumatorë, ku vëllimi i ujërave të ndotura ndryshon me vëllimin e ujit nga ofruesi i shërbimeve.
5. Llogaritjet kryhen në çmime reale, me indeksim vjetor sipas inflacionit.
6. Autoriteti ka të drejtë të ndryshojë të dhënat e propozuara të ofruesit të shërbimeve, nëse vlerëson se nuk përmbushin kriteret e besueshmërisë, efikasitetit dhe realizueshmërisë.

Neni 11

Struktura e tarifave

1. Struktura tarifore për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura përbëhet nga një kombinim tarifash fikse dhe të bazuara në vëllim.
2. Struktura e tarifave për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit përfshin:
 - 2.1 Tarifën fikse mujore;
 - 2.2 Tarifën volumetrike të ujit;
 - 2.3 Tarifën volumetrike të ujërave të ndotura;
 - 2.4 Tarifën shtesë për ujërat e ndotura, për ata konsumatorë që janë subjekt i tarifave për konsumatorët biznes/industri, kur cilësia e ujërave të ndotura në përbërje ndryshon nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura.
 - 2.5 Tarifën për realizimin fizik të lidhjes së re;
 - 2.6 Tarifën për inspektimin e lokacionit për lidhje të re dhe pranimi teknik i lidhjes;
 - 2.7 Tarifën për ndërprerjen e përkohshme të lidhjes;
 - 2.8 Tarifën për rilidhje në rrjetin e ujësjellësit;
 - 2.9 Tarifën për ndërprerjen e përhershme të lidhjes;
 - 2.10 Tarifën për testim, riparim dhe kalibrim të ujëmatësit;
 - 2.11 Tarifën e mbingarkesës.

Neni 12

Tarifa e mbingarkesës

1. Secili aplikues për lidhje në rrjetin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe regjistrohet si konsumator i ri në sistemin e ofruesit të shërbimeve, obligohet të paguajë tarifën e mbingarkesës.
2. Tarifa e mbingarkesës dhe përforcimit të infrastrukturës aplikohet për konsumatorët e rinj, me qëllim të mbulimit të kostove të përforcimit, zgjerimit dhe përmirësimit të kapaciteteve të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, si rezultat i rritjes së kërkesës për shërbime.
3. Për shtëpitë e reja të banimit, tarifa paguhet nga pronari i objektit, ndërsa për objektet shumëkatëshe tarifa paguhet nga pronarët e njësisve banesore në momentin e instalimit të ujëmatësve individualë dhe regjistrimit si konsumatorë të rinj.
4. Të hyrat nga tarifa për përforcimin e infrastrukturës dedikohen ekskluzivisht për financimin e investimeve kapitale që lidhen me përforcimin, zgjerimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.
5. Ofruesi i shërbimeve obligohet të krijojë dhe të mirëmbajë llogari të veçantë financiare për administrimin e të hyrave nga kjo tarifë, e cila përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni.
6. Zbatimi i tarifës së mbingarkesës bëhet vetëm pasi ofruesi i shërbimeve të ketë përmbushur kushtet e nevojshme teknike, administrative dhe financiare.
7. Autoriteti monitoron dhe kontrollon zbatimin e tarifës së mbingarkesës, me fokus të veçantë në dedikimin e të hyrave sipas paragrafit 4 të këtij neni, dhe në rast të mos-përmbushjes së detyrimeve nga ofruesi i shërbimeve, ndërmer masa proporcionale në përputhje me kornizën rregullative në fuqi.
8. Autoriteti përgatit dhe miraton udhëzues për zbatimin e tarifës së mbingarkesës, i cili përcakton metodologjinë, procedurat dhe kërkesat teknike, administrative dhe financiare për aplikimin e saj nga ofruesit e shërbimeve.

KREU IV

PROCEDURA E APLIKIMIT DHE SHQYRTIMIT TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT

Neni 13

Aplikacioni për tarifat e shërbimit

1. Ofruesit e Shërbimeve detyrohen të paraqesin aplikacion sipas afateve të përcaktuara në përputhje me Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.
2. Ofruesi i shërbimeve do të sigurojë informacione shtesë për të mbështetur aplikacionin e tarifave të shërbimit, siç kërkohet nga Autoriteti.

3. Aplikacioni i tarifave të shërbimit, Shtojcë 2 e kësaj Rregulloreje, duhet të miratohet nga Bordi i Drejtorëve të ofruesit të shërbimeve që dëshmohet me letrën përcjellëse të nënshkruar.
4. Nëse ofruesi i shërbimeve nuk i dorëzon të dhënat sipas afateve të kërkuara, Autoriteti do të përcaktojë tarifën e shërbimit bazuar në vlerësimet për kërkesën e të hyrave, nivelin e pritshëm të efikasitetit dhe performancës operative.
5. Nëse, ofruesi i shërbimeve, nuk aplikon fare për tarifa, atëherë Autoriteti do t'i caktojë vetë tarifën e shërbimit, mbështetur në vlerësimet e veta, duke vendosur tarifa në favor të konsumatorit, si dhe do të ndërmerren masa ligjore për mos përmbushje të detyrimeve.
6. Në rrethana të jashtëzakonshme apo të imponuara nga kushte objektive dhe të paparashikueshme, Autoriteti mund të vendos një proces tarifor njëvjeçar, apo vazhdimin e tarifave të miratuara nga viti paraprak, deri në krijimin e kushteve për zhvillimin e një procesi të ri tarifor.

Neni 14

Shqyrtimi i aplikacionit

1. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, Autoriteti do të konfirmojë pranimin e aplikacionit të tarifave të shërbimit dhe kompletueshmërinë e dokumentacionit sipas Shtojcës 2.
2. Nëse aplikacioni i dorëzuar nuk është i kompletuar, Autoriteti do të kërkojë nga aplikuesi që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve të ofrojë informacionet dhe dokumentet e nevojshme për ta kompletuar aplikacionin.
3. Në rast se aplikuesi nuk e korrigjon aplikacionin ose nuk dorëzon dokumentet e nevojshme brenda periudhës së caktuar në paragrafin 2 të këtij neni, Autoriteti do të marrë një vendim me shkrim bazuar në dokumentet e dorëzuara, përmes të cilit do të njoftohet aplikuesi.
4. Autoriteti do të shqyrtojë, analizojë dhe sfidojë të dhënat e ofruesve të shërbimit për të siguruar performancë më të mirë, në bazë të:
 - 4.1 Përputhshmërisë së tij me procedurat, kërkesat për informacion dhe kërkesat tjera rregullatore;
 - 4.2 Parashikimeve të performancës teknike dhe financiare në të cilat është bazuar aplikacioni për tarifa shërbimi, të cilat do të përmbushin pritjet e Autoritetit, të përmbushjes së caqeve reale dhe për të përcaktuar pritshmërinë e performancës;
 - 4.3 Kostove operative të cilat do të reflektojnë përmirësimet sfiduese të efikasitetit siç është përcaktuar nga Autoriteti;
 - 4.4 Parashikimeve të shpenzimeve për investime kapitale për përmbushjen e standardeve të shërbimit ose niveleve tjera të shërbimit;
 - 4.5 Performancës ekonomike dhe financiare të ofruesit të shërbimeve, duke e krahasuar me performancën e pritur ose aktuale të ofruesve tjerë të shërbimeve. Gjatë këtij krahasimi do të merren për bazë faktorët jo tipik, pengesat topografike, ekonominë

e shkallës dhe të ngjashme.

KREU V KONSULTIMET PUBLIKE

Neni 15

Vendimi për mbajtjen e konsultimeve me publikun dhe palët e interesit

1. Konsultimet me palët e interesit zhvillohen sipas planit të përgatitur nga Departamenti Tarifave, i cili duhet të miratohet me vendimin e Drejtorit të Autoritetit.
2. Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni përcakton:
 - 2.1. Personin përgjegjës i cili i udhëheq konsultimet me palët e interesit;
 - 2.2. Personat e tjerë të ngarkuar për mbarëvajtjen e konsultimeve me palët e interesit;
 - 2.3. Çdo çështje tjetër të përshtatshme.

Neni 16

Organizimi i konsultimeve me publikun dhe palët e interesit

1. Autoriteti organizon konsultime me publikun dhe palët e interesit pas dorëzimit të aplikacionit tarifor nga ofruesi i shërbimeve tek Autoriteti dhe para miratimit të Biznes Planit Rregullator për procesin tarifor tre vjeçar.
2. Autoriteti organizon konsultime me publikun dhe palët e interesit në secilin rajon të ofruesit të shërbimeve, por sipas nevojës mund të organizojnë edhe në komuna të tjera të zonës referuese.

Neni 17

Prezantimi i tarifave të procesit tarifor

1. Ofruesi i shërbimeve përgatit një prezantim nga BPRR, që justifikon propozimin për nivelin e ri tarifor që duhet paraqitur gjatë mbajtjes së konsultimeve me palët e interesit sipas shtojcës 1 kësaj Rregulloreje.
2. Për të garantuar nëse është respektuar formati i prezantimit dhe përmbajtja e tij, ofruesi i shërbimeve duhet ta dërgojë atë paraprakisht për miratim pranë Autoritetit.
3. Pas miratimit, prezantimi duhet të jetë i publikuar në ueb faqen e ofruesit të shërbimeve dhjetë (10) ditë para datës së mbajtjes së konsultimeve me palët e interesit.

Neni 18

Njoftimi për konsultime me publikun dhe palët e interesit

1. Autoriteti njofton për mbajtjen e konsultimeve me palët e interesit të paktën dhjetë (10) ditë përpara mbajtjes së tij nëpërmjet njoftimeve të shpallura:
 - 1.1. në ueb faqe zyrtare të Autoritetit;
 - 1.2. njoftimet në ambientet e jashtme të objektit të Autoritetit dhe ofruesit të shërbimeve nëpërmes komunikatës për mediat e shkruara dhe elektronike.
2. Njoftimi duhet të përmbajë informacion mbi datën, orën, vendin dhe qëllimin e mbajtjes së konsultimeve me palët e interesit.

Neni 19

Procedurat e mbajtjes së konsultimeve me publikun dhe palët e interesit

1. Konsultimi me publikun dhe palët e interesit janë të hapura për të gjithë banorët e zonës së shërbimit të ofruesit të shërbimeve dhe të gjitha palët tjera të interesit.
2. Prezantimi i propozimit për tarifa të procesit të ri tre (3) vjeçar bëhet nga përfaqësuesit e ofruesit të shërbimeve.
3. Procesverbali i konsultimeve me publikun dhe palët e interesit, pavarësisht se regjistrohet apo jo, duhet të mbahet nga personi i autorizuar nga Autoriteti.

Neni 20

Rregullat e mbajtjes së konsultimeve me publikun dhe palët e interesit

1. Gjatë mbajtjes së konsultimeve me publikun dhe palët e interesit, duhet të ruhet etika e komunikimit.
2. Personi drejtues i konsultimeve me publikun dhe palët e interesit do të sigurojë të drejtën e fjalës për secilën nga palët e pranishme.
3. Drejtuesi i konsultimeve me publikun dhe palët e interesit, duhet të ketë parasysh që pyetjet dhe vërejtjet që vijnë nga publiku shpesh janë të formuluar në mënyra dhe forma që mund të jenë jashtë kontekstit dhe termave që përdoren në menaxhimin e shërbimeve me ujë dhe ujëra të ndotura. Në këtë rast, për të shmangur përplasjet dhe debatet jo konstruktive, duhet bërë kujdes që sqarimi për qytetarët të jetë sa më i thjeshtë dhe i kuptueshëm dhe brenda normave të etikës dhe profesionalizmit.
4. Palët gjatë seancës dëgjimore mund të paraqesin edhe komente me shkrim të cilat administrohen nga Autoriteti.

Neni 21

Transkriptimet

1. Nëse seanca e konsultime me publikun dhe palët e interesit incizohet, çdo deklaratë e bërë gjatë diskutimit transkriptohet (zbardhet) në një raport të saktë, pa hequr asgjë, përveç kur personi drejtues urdhëron me shkrim heqjen e shprehjeve eventuale fyese të regjistruara.
2. Çdo korrigjim në transkriptimin e një konsultimi me publikun dhe palët e interesit mund të bëhet, vetëm nëse personi drejtues vendos se korrigjimi përputhet me regjistrimin audio ose audioviziv.

Neni 22

Dokumentacioni

1. I gjithë dokumentacioni i konsultimeve me publikun dhe palët e interesit, administrohet nga Departamenti i Tarifave të Autoritetit, në dosjen e konsultimeve me publikun dhe palët e interesit.
2. Dosja ruhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 23

Raportimi

1. Drejtuesi i konsultimit publik (nga ARRU) brenda pesë (5) ditë pune nga përfundimi i konsultimeve me publikun dhe palët e interesit, përgatit një raport me shkrim lidhur me komentet e marra gjatë diskutimit në fjalë, konkluzionet, rekomandimet dhe ia paraqet drejtorit të Autoritetit.
2. Një kopje e këtij raporti dhe prezantimi i nivelit të ri tarifor, pas miratimit, arkivohet në Departamentin e Tarifave.

KREU VI

PROCEDURAT E MIRATIMIT DHE RISHIKIMIT TË TARIFËS

Neni 24

Miratimi i tarifave të shërbimit

Miratimi i tarifave të shërbimit bëhet nga Autoriteti në përputhje me këtë Rregullore, pas shqyrtimit të aplikacionit tarifor dhe vlerësimit të kriterëve përkatëse, përmes nxjerrjes së Urdhëresës Tarifore.

Neni 25

Rishikimi i jashtëzakonshëm i tarifave gjatë periudhës tarifore

1. Gjatë periudhës tarifore, Autoriteti mund të vendosë për rishikim të jashtëzakonshëm të tarifave në rast të ndryshimeve të konsiderueshme ndërmjet të dhënave të miratuara në procesin tarifor dhe të dhënave reale të realizuara dhe kur vlerësohet se këto ndryshime ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në kostot dhe performancën e Ofruesit të Shërbimeve.
2. Rishikimi i jashtëzakonshëm mund të realizohet gjatë vitit të parë ose të dytë të periudhës tarifore në fuqi. Rishikimi nuk lejohet gjatë vitit të tretë të periudhës tarifore, pasi efektet përkatëse do të trajtohen në procesin pasues tarifor.
3. Në rast të rishikimit gjatë vitit të parë, dallimet e konstatuara ndërmjet të dhënave të miratuara dhe atyre reale do të shpërndahen proporcionalisht në dy (2) vitet e mbetura të periudhës tarifore.
4. Në rast të rishikimit gjatë vitit të dytë, dallimet e konstatuara do t'i ngarkohen vitit të tretë të periudhës tarifore.
5. Në rast se periudha tarifore është pesë (5) vjeçare, rishikimi i jashtëzakonshëm i tarifave mund të realizohet gjatë viteve të para të periudhës tarifore, përveç vitit të fundit, dhe dallimet e konstatuara ndërmjet të dhënave të miratuara dhe atyre reale do të shpërndahen proporcionalisht në vitet e mbetura të periudhës tarifore në fuqi. Rishikimi nuk lejohet gjatë vitit të pestë, pasi efektet përkatëse do të trajtohen në procesin pasues tarifor.
6. Rishikimi i jashtëzakonshëm do të bëhet në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara nga Autoriteti.

Neni 26

Procedurat e miratimit për rishikim të jashtëzakonshëm të tarifave të shërbimit

1. Rishikimi i jashtëzakonshëm i tarifave gjatë periudhës rregullatore mund të iniciohet si nga Autoriteti ashtu edhe nga ofruesit e shërbimeve, kur plotësohet së paku një nga kushtet e mëposhtme: (R. Rama, V. Duraku, H. Feka)
 - 1.1. ndryshimi i zërave kryesorë të shpenzimeve operative, të cilët janë jashtë kontrollit të ofruesit të shërbimeve, kur devijimi i tyre tejkalon $\pm 30\%$ krahasuar me nivelet e parashikuara në tarifën e miratuar.
 - 1.2. Autoriteti mund të miratojë rishikim të pjesshëm korrigjues të tarifave kur devijimi neto i të ardhurave të rregulluara tejkalon një nivel që Autoriteti e vlerëson si të arsyeshëm për rishikim.
2. Autoriteti do të konfirmojë që kërkesa për rishikime të jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit është në përputhje me Rregulloren mbi Tarifat e Shërbimit, të vlerësojë dhe të përgjigjet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të aplikacionit.

3. Autoriteti do të vlerësojë kërkesën për rishikim të jashtëzakonshëm të tarifave të shërbimit, në pajtim me procedurat e aplikuara.
4. Nëse kërkesa për korrigjim të jashtëzakonshëm i përmbushë kriteret e parapara, atëherë Autoriteti do ta miratojë atë me shkrim.
5. Nëse kërkesa e dorëzuar nuk është e kompletuar, Autoriteti do të kërkojë nga ofruesi i shërbimeve që brenda afatit prej pesë (5) ditëve të punës të ofrojë informacionet dhe dokumentet e nevojshme për ta kompletuar dokumentacionin.
6. Në rast se ofruesi i shërbimeve nuk dorëzon dokumentet e nevojshme brenda periudhës së caktuar në paragrafin 4 të këtij neni, Autoriteti do të marrë një vendim me shkrim bazuar në dokumentet e dorëzuara.
7. Autoriteti mund të refuzojë kërkesën për rishikim të jashtëzakonshëm të tarifave të shërbimit nëse ofruesi i shërbimeve ka dështuar të sigurojë informacionet e kërkuara brenda afatit të caktuar ose kërkesa nuk është financiarisht e arsyeshme;

KREU VII PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT

Neni 27 Publikimi i tarifave të shërbimit

1. Tarifat e shërbimit të miratuara nga Autoriteti publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit dhe në faqen zyrtare të ofruesit të shërbimeve përkatëse.
2. Vendimi i Autoritetit dhe Urdhëresa e Tarifave të Shërbimit publikohen jo më vonë se 20 tetor të vitit aktual.
3. Tarifat e reja hyjnë në fuqi nga data 1 janar e vitit pasues.

KREU VIII FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM PËR QËLLIME TREGTARE DHE ANKESAT

Neni 28 Furnizimi me ujë të pijshëm për qëllime tregtare

1. Ofruesit të shërbimeve nuk i lejohet të furnizojë me ujë të pijshëm konsumatorët që e përdorin ujën si lëndë të parë në proces prodhimi për qëllime tregtare, përfshirë, por pa u kufizuar në prodhimin e ujit të ambalazhuar, pijeve, produkteve ushqimore apo veprimtari të tjera prodhuese, pa miratim paraprak nga Autoriteti.
2. Furnizimi me ujë për qëllime tregtare mund të realizohet vetëm në bazë të një marrëveshjeje

të veçantë ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorit, e cila duhet të miratohet paraprakisht nga Autoriteti, duke vlerësuar ndikimin në sigurinë dhe vazhdimësinë e furnizimit të përgjithshëm me ujë të pijshëm.

3. Ofruesi i shërbimeve është i detyruar të siguroj që asnjë furnizim me ujë për qëllime tregtare të mos cenojë furnizimin e rregullt dhe të qëndrueshëm të konsumatorëve të tjerë, dhe nuk mund të hyjë në marrëveshje që bien në kundërshtim me interesin publik.
4. Çdo furnizim ose marrëveshje për përdorimin e ujit të pijshëm për qëllime tregtare pa miratim paraprak nga Autoriteti do të konsiderohet shkelje e kësaj Rregulloreje dhe do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 29

Ankesat

Çdo palë e pakënaqur me vendimet e Autoritetit të nxjerra lidhur me përcaktimin e tarifave të shërbimeve në zbatim të kësaj Rregulloreje ka të drejtë të ushtrojë ankesë pranë Komisionit Shqyrtues, në pajtim me procedurat e përcaktuara me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

KREU IX

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 30

Aplikimi i ndërsubvencionimit

1. Ndërsubvencionimi ekzistues ndërmjet kategorive të konsumatorëve shtëpiak dhe joshtëpiak eliminohet në mënyrë graduale, duke përfunduar në procesin e ardhshëm tarifor 2029-2031.
2. Eliminimi i ndërsubvencionimit do të realizohet përmes harmonizimit gradual të strukturës tarifore, duke marrë parasysh përballueshmërinë për konsumatorët, qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve, si dhe parimin e kostos reale të ofrimit të shërbimeve.

Neni 31

Aplikimi i tarifës së mbingarkesës

1. Tarifa e mbingarkesës, e përcaktuar në nenin 12 të kësaj Rregulloreje, do të fillojë së zbatuari nga data 1 janar 2027, duke u bërë e detyrueshme për zbatim nga kjo datë për të gjithë subjektet përkatëse.

KREU X
DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 32
Gjuha zyrtare

Kjo Rregullore miratohet dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 33
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Autoritetit.

Datë

Drejtori i ARRU

SHTOJCAT

SHTOJCA NR. 1 – AKTIVITETET KRYESORE DHE AFATET KOHORE TË PROCESIT TARIFOR

Tabela 1 – Aktivitetet kryesore për tarifatat e ujit me shumicë

Afati	Aktiviteti	Përgjegjësia	
		KRU dhe IL	ARRU
deri më 30 Shtator (viti bazë-1)	Konsultimet me publikun dhe palët e interesit rreth politikave dhe procedurave të përcaktimit të tarifave	•	•
15-20 dhjetor (viti bazë-1)	Vendimet e ARRU-së pas konsultimeve dhe propozimeve nga publiku dhe palët e interesit.		•
Deri më 31 mars (viti bazë)	Inkorporimi i propozimeve në modelin tarifor për përcaktimin e tarifave dhe dokumentacionit mbështetës. Të mbështetura me punëtori dhe aktivitete të tjera. Aplikimi i ofruesve të shërbimeve për proces tarifor.		•
Deri më 15 prill (viti bazë)	Dorëzimi i planeve të biznesit, propozimeve për tarifa dhe informacionit mbështetës.	•	
Deri më 30 prill (viti bazë)	Shqyrtimi i propozimeve dhe publikimi i draftit të Biznes Planeve Rregullatore.		•
Deri më 20 maj (viti bazë)	Publikimi i vendimit të tarifave përfundimtare të shërbimeve të ujit me shumicë. Publikimi i vendimeve për tarifatat për vitin bazë +1 (me tarifa të përshtatura sipas normave të inflacionit).		•

Tabela 2 – Aktivitetet kryesore për tarifatat e ujit me pakicë

Afati	Aktiviteti	Përgjegjësia	
		KRU	ARRU
deri më 30 Shtator (viti bazë-1)	Konsultimet me publikun dhe palët e interesit rreth politikave dhe procedurave të përcaktimit të tarifave	•	•
15-20 dhjetor (viti bazë-1)	Vendimet e ARRU-së pas konsultimeve dhe propozimeve nga publiku dhe palët e interesit.		•
Deri më 31 mars (viti bazë)	Inkorporimi i propozimeve në modelin tarifor për përcaktimin e tarifave dhe dokumentacionit mbështetës. Të mbështetura me punëtori dhe aktivitete të tjera. Aplikimi i ofruesve të shërbimeve për proces tarifor.		•
Deri më 31 maj (viti bazë)	Dorëzimi i planeve të biznesit, propozimeve për tarifa dhe informacionit mbështetës.	•	
Deri më 31 korrik (viti bazë)	Shqyrtimi i propozimeve dhe publikimi i draftit të Biznes Planeve Rregullatore.		•
Deri më 15 shtator (viti bazë)	Afati për komente dhe konsultime nga KRU-të lidhur me përcaktimet e draftit për tarifa	•	
Deri më 10 tetor (viti bazë)	Konsultime publike për tarifatat e propozuara	•	•
Deri më 20 tetor (viti bazë)	Publikimi i tarifave përfundimtare të shërbimeve të ujit. Publikimi i vendimeve për tarifatat për vitin bazë +1 (me tarifa të përshtatura sipas normave të inflacionit).		•
Deri më 20 tetor (viti bazë +1 vit)	Publikimi i vendimeve për tarifatat për vitin bazë +2 (me tarifa të përshtatura sipas normave të inflacionit).		•
Deri më 20 tetor (viti bazë +2 vite)	Publikimi i vendimeve për tarifatat për vitin bazë +3 (me tarifa të përshtatura sipas normave të inflacionit).		•

SHTOJCA NR. 2 - LISTA E DOKUMENTEVE PËR APLIKIM NË PROCES TARIFOR

Lista e dokumenteve që duhet bashkangjitur aplikacionit për tarifat e shërbimeve	
1	Formulari i aplikimit tarifor;
2	Pasqyrat financiare vjetore të audituara
3	Autorizim nga Organi epror (Bordi i Drejtorëve) për personin të cilit i është dhënë e drejta për aplikim
4	Deklaratë e aplikuesit për saktësinë e informacionit të prezantuar për çështje të tarifave
5	Plotësimin e të dhënave në modelin softuerik të kalkulimit të tarifave
6	Plotësimin e formularit për arsyeshmërinë e investimeve kapitale për procesin tarifor
7	Kopjen e Planit të Biznesit
8	Plani i Menaxhimit të Aseteve
9	Planet afatgjata të investimeve
10	Planet e menaxhimit të thatësisë
11	Planet e furnizimit me ujë në situata të emergjencave
12	Informata shtesë, të cilat mund të sqarojnë të dhënat dhe lehtësojnë punën e vendimmarrjes së ARRU-së, për përcaktimin e tarifave.

SHTOJCA 3 – FORMULARI I APLIKIMIT PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE TË UJIT

1. TË DHËNAT E APLIKUESIT

1.1 Aplikuesi për tarifatat e shërbimit	
1.2 Adresa e plotë:	
1.3 Numri i telefonit të ofruesit të shërbimeve:	
1.4 E-maili i ofruesit të shërbimeve:	
1.5 Emri dhe mbiemri i personit kontaktues:	
1.6 Numri i telefonit të personit kontaktues	

2. LLOJI I APLIKACIONIT

<input type="checkbox"/> Proces i rregullt tarifor	
<input type="checkbox"/> Proces i jashtëzakonshëm tarifor	
<input type="checkbox"/> Proces i rishikimit tarifor	

3. KATEGORIA E SHËRBIMIT

<input type="checkbox"/> Kategoria A: Shërbimet e ujës-jellës	
<input type="checkbox"/> Kategoria B: Shërbimet e Kanalizimit	
<input type="checkbox"/> Kategoria C: Shërbimet e Ujërave të Ndotura	
<input type="checkbox"/> Kategoria D: Uji i Papërpunuar me Shumicë	
<input type="checkbox"/> Kategoria E: Uji i Përpunuar me Shumicë	

4. DEKLARATA E APLIKUESIT

Me përgjegjësi të plotë ligjore deklaroj se, të dhënat dhe informacionet e paraqitura në këtë aplikacion dhe në dokumentet e bashkëngjitura janë të vërteta, të sakta dhe në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Rregullorja për Përcaktimin e Tarifave. Zotohem që do të ndjek dhe zbatoj në mënyrë të plotë dhe të përpiktë të gjitha dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë përkatëse, përfshirë aktet e nxjerra nga Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit.

Data:	
Vendi:	
Emri dhe Mbiemri i personit të autorizuar:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	

SHTOJCA 4: TE DHËNAT QE DUHET TË PUBLIKOHEN NË KONSULTIM PUBLIK PËR PROCESIN TARIFOR, PËR KRU-të

Tabela 1. Të dhënat operative

Kategoria e të dhënave	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Të dhënat operative					
1.1 Uji i prodhuar	m ³ /vit				
1.2 Uji i humbur	m ³ /vit				
1.3 Uji i humbur në përqindje	%				
1.4 Uji i faturuar	m ³ /vit				
2. Numri i konsumatorëve					
2.1 Shtëpiak	Nr.				
2.2 Komercial/Industrial	Nr.				
2.3 Institucional	Nr.				
Gjithsej:	Nr.				
3. Numri i punëtorëve					
3.1 Shërbimet e ujësjellësit	Nr.				
3.2 Shërbimet e ujërave të ndotura	Nr.				
Gjithsej:	Nr.				
4. Mbulueshmëria me shërbime					
4.1 Ujësjiellës	%				
4.2 Kanalizim	%				
4.3 Trajtimit i ujërave të ndotura	%				
5. Gjatësia e rrjetit					
5.1 Rrjeti i ujësjellësit	km				
5.2 Rrjeti i kanalizimit	km				

Tabela 2. Shpenzimet operative

Kategoria e shpenzimeve për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Shërbimet e ujësjellësit					
1.1 Resurse dhe trajtim	€/vit				
1.2 Distribuim	€/vit				
1.3 Aktivitete biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura					
2.1 Grumbullimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.2 Trajtimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.3 Trajtimi i llumit	€/vit				
2.4 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				

Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				
--	-------	--	--	--	--

Tabela 3. Faturimi

Kategoria e faturimit për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Shërbimet e ujësjellësit te konsumatorët					
1.1 Shtëpiak	€/vit				
1.2 Komercial/Industrial	€/vit				
1.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura te konsumatorët					
2.1 Shtëpiak	€/vit				
2.2 Komercial/Industrial	€/vit				
2.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
3. Tarifa fikse					
3.1 Shtëpiak	€/vit				
3.2 Komercial/Industrial	€/vit				
3.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				

Tabela 4. Arkëtimi

Kategoria e arkëtimit për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Shërbimet e ujësjellësit te konsumatorët					
1.1 Shtëpiak	€/vit				
1.2 Komercial/Industrial	€/vit				
1.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura te konsumatorët					
2.1 Shtëpiak	€/vit				
2.2 Komercial/Industrial	€/vit				
2.3 Institucional	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				
3. Shkalla e arkëtimit te konsumatorët					
3.1 Shtëpiak	%				
3.2 Komercial/Industrial	%				
3.3 Institucional	%				
Gjithsej:	%				

Tabela 5. Investimet kapitale prej burimeve vetjake

Investimet kapitale vetjake për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Shërbimet e ujësjellësit					
1.1 Resurse dhe trajtim	€/vit				
1.2 Distribuum	€/vit				
1.3 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura					
2.1 Grumbullimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.2 Trajtimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.3 Trajtimi i llumit	€/vit				
2.4 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				

Tabela 6. Investimet kapitale prej donacioneve

Investimet kapitale nga donatorët për:	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
1. Shërbimet e ujësjellësit					
1.1 Resurse dhe trajtim	€/vit				
1.2 Distribuum	€/vit				
1.3 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
2. Shërbimet e ujërave të ndotura					
2.1 Grumbullimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.2 Trajtimi i ujërave të ndotura	€/vit				
2.3 Trajtimi i llumit	€/vit				
2.4 Aktivitete Biznesore	€/vit				
Gjithsej:	€/vit				
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit				

Tabela 7. Tarifa volumetrike dhe fikse për shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura

Tarifat sipas kategorisë së shërbimeve dhe konsumatorëve	Njësia	Viti bazë	Viti tarifor 1	Viti tarifor 2	Viti tarifor 3
Tarifa volumetrike për shërbimet e ujësjellësit					
Shtëpiak	€/m ³				
Joshtëpiak	€/m ³				
Tarifa volumetrike për shërbimet e ujërave të ndotura					
Shtëpiak	€/m ³				
Joshtëpiak	€/m ³				
Tarifa fikse mujore					
Shtëpiak	€/muaj				
Joshtëpiak	€/muaj				

